

Plan Zbatues

Parimet e mëposhtme janë dakorduar nga të dyja palët për organizimin e punës së Komisionit Zbatues.

- hapat e zbatimit në të gjitha fushat e renditura më poshtë duhet të ndërmerren në të njëjtën kohë.

- ky plan do t'i nënshtrohet përditësimit, sipas nevojës, nga të dyja palët në Komisionin Zbatues.

- të dyja palët do të vazhdojnë të bëjnë çdo përpjekje për ta informuar bazën e tyre deleguese gjegjëse lidhur me përmbajtjen e "Marrëveshjes së Parë" dhe të Planit Zbatues.

Zbatimi do të përbëhet nga gjashtë elementet kryesore:

- përshtatja e kornizave ligjore
- Asociacioni /Bashkësia
- policia
- drejtësia
- zgjedhjet komunale
- dispozitat e përgjithshme

1. Përshtatja e kornizave ligjore:

Fundi i Majit:

Të dyja palët do t'ia paraqesin Komisionit Zbatues për diskutim planet dhe afatet e tyre kohore të detajuara për ndryshimet juridike të nevojshme për zbatimin e "Marrëveshjes së Parë"

Deri kah mesi i Qershorit:

Të dyja palët do t'i kenë miratuar të gjitha ndryshimet juridike të domosdoshme që kërkohen për zbatimin e "Marrëveshjes së Parë", duke përfshirë Ligjin për Amnistinë.

2. Asociacioni/Bashkësia:

Deri në fund të Majit:

Të dyja palët do të krijojnë një Ekip Menaxhues për themelimin e Asociacionit/Bashkësisë, me termat e referencës të definuara nga Komisioni Zbatues. Në këto terma të referencës do të përfshihet përgatitja e një draft statuti. Ekipi do të ngarkohet me të gjitha çështjet relevante për themelimin e këtij Asociacioni/Bashkësie dhe do të ketë, për një periudhë të përkohshme,

kompetencat e parashikuara në nenet 4 dhe 6 të “Marrëveshjes së Parë”. Ekipi Menaxhues do të përbëhet prej përfaqësuesve nga katër komunat veriore dhe do të krijohet pas një miratimi formal nga autoriteti kompetent i Kosovës. Komisioni Zbatues do ta monitorojë punë e Ekipit Menaxhues.

Deri në fund të Tetorit:

Pas zgjedhjeve komunale, dhe pas validimit të rezultateve të këtyre zgjedhjeve, Ekipi Përgatitor do të shpërndahet. Asociacioni/Bashkësia sipas nenit 1 të “Marrëveshjes së Parë” do të themelohet dhe do ta miratojë Statutin e tij/saj, në pajtim me Kartën Evropiane mbi Vetëqeverisjes Lokale dhe ligjin e Kosovës.

3. Policia:

Fundi i Majit:

Të dyja palët do ta krijojnë një grup punues për zbatimin e neneve 7-9 të “Marrëveshjes së Parë”. Grupi punues do të hartojë plane dhe afate kohore të detajuara për integrimin e personelit serb të sigurisë në strukturat e Kosovës dhe krijimin e çdo strukture të re të nevojshme sipas marrëveshjes, që do të realizohet me ndihmën e EULEX-it.

Një ushtrues detyre i Komandantit Rajonal të Policisë për katër komunat veriore do të emërohet në përputhje me nenin 9 të “Marrëveshjes së Parë”.

Deri kah mesi i Qershorit:

Serbia do të fillojë mbylljen e objekteve të strukturave të saj të sigurisë në Kosovë.

Serbia do të paraqesë informacion të detajuar mbi numrin dhe gradën e të punësuarve të qeverisë së Serbisë në sektorin e sigurisë në Kosovë që kanë shprehur interes t’u bashkohen strukturave të Kosovës.

Kosova do të ofrojë poste ne Policinë e Kosovës dhe në strukturat e tjera ekuivalente, bazuar, deri në shkallën që është e mundur, në vendin e banimit.

Serbia do të iniciojë procedurat e brendshme të nevojshme për ndërprerjen e pagesës së rrogave për personelin pas inkorporimit të tyre në strukturat ekuivalente të Kosovës, dhe t’ia paraqesë këto grupit punues. Ky proces do të fillojë në rastin e personelit që tashmë është duke shërbyer në Policinë e Kosovës.

Deri kah mesi i Korrikut:

Të gjitha objektet e strukturave serbe të sigurisë në Kosovë do të mbyllen.

Deri kah fundi i vitit:

Pjesëtarët e strukturave serbe të sigurisë në Kosovë do të jenë plotësisht të integruara në strukturat ekuivalente të Kosovës dhe pagat do të paguhen ekskluzivisht nga buxheti i Kosovës.

4. Drejtësia:

Deri kah fundi i Majit:

Të dyja palët do të krijojnë një grup punues për zbatimin e nenit 10 të "Marrëveshjes së Parë". Grupi punues do të hartojë plane të detajuara për integrimin e autoriteteve gjyqësore serbe në strukturat e Kosovës dhe themelimin e çdo strukture të re sipas marrëveshjes, duke përfshirë gjykatat dhe prokuroritë themelore në komunat me shumicë serbe që do të realizohen në kuadër të kornizës gjyqësore të Kosovës dhe me ndihmën e EULEX-it.

Do të dakordohet një datë dhe plan për ndaljen e lëndëve të reja që po trajtohen në kuadër të sistemit të gjykatave serbe në Kosovë.

Deri kah fundi i Qershorit:

Serbia do të paraqesë informatë lidhur me numrin e personelit të saj gjyqësor të punësuar në Kosovë, që kanë shprehur interesin për t'iu bashkuar strukturave të Kosovës, menjëherë pasi të jetë miratuar Ligji për Amnistinë.

Kosova do të vë në dispozicion poste në strukturat e saj gjyqësore.

Përbërja e gjyqësorit duhet ta pasqyrojë përbërjen etnike të kompetencës territoriale të secilës gjykatë gjegjëse.

Deri kah fundi i vitit:

Integrimi i autoriteteve gjyqësore duhet të ketë përfunduar. Të gjitha objektet e gjykatave serbe në Kosovë duhet të jenë mbyllur, me ngritjen e organeve të reja, dhe me personelin e integruar në sistemin e Kosovës. Nuk do të ketë zbrazëti në shërbime.

5. Zgjedhjet komunale:

Deri në javën e parë të Qershorit

Komisioni Zbatues do të iniciojë diskutime në lidhje me mbajtjen e zgjedhjeve komunale. OSBE-ja do të marrë pjesë në këto diskutime, dhe do të udhëheqë çdo grup punues të nevojshëm mbi këtë temë.

Deri në fund të Tetorit:

Zgjedhjet komunale janë mbajtur.

6. Dispozitat e përgjithshme

- **Transparenca e financimit:** Deri në fund të Majit, Serbia do të paraqesë pasqyrën e përgjithshme të detajuar e të gjitha financimeve të institucioneve në Kosovë përmes Komitetit Zbatues. Deri kah mesi i Korrikut, nga të dyja palët në Komisionin Zbatues do të definohet metoda e parimeve përmbushëse për financim transparent.

- **Zbatimi i plotë i të gjitha marrëveshjeve** të arritura më parë në procesin e Dialogut. Të dyja palët zotohen për zbatimin e plotë të marrëveshjeve të arritura më parë, domethënë:

Kadastr

Regjistrat civilë

Vulat doganore

Diplomat universitare

Liria e lëvizjes

Përfaqësimi rajonal

IBM [Menaxhimi i Integruar i Kufirit]

Aranzhimet e ndërlidhjes

Njësi e posaçme e policisë për mbrojtjen e Trashëgimisë Religjioze dhe Kulturore

Mbledhja e tatimeve/krijimi i fondit për veriun e Kosovës

Të dyja palët do ta vazhdojnë dialogun e tyre politik.